



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	<u>DMM</u>
Nr. Prot. Broj.Prot. Prot.No.	<u>1872-2/26</u>
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	<u>04</u>
Data Datum. Date	<u>23.08.2026</u>
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	28.08.2026
REFERENC-Ë:	26/1872/374/DMM
PËR/ZA/TO:	"Qallaku Petroll" Sh.p.k., Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/1872/374/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të Procedurës Administrative për kërkesën e kompanisë "Qallaku Petroll" Sh.p.k., Pejë - për impiantin për përpunim, thërrmim dhe seperimi i rërës dhe zhavorrit në Pejë.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Përfundim të Procedurës Administrative të kërkesës së kompanisë "Qallaku Petroll" Sh.p.k., Pejë - për impiantin për përpunim, thërrmim dhe seperimi i rërës dhe zhavorrit në ngastren kadastrale P-71611071-05633-16 në Z.K., Pejë.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të Kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Qallaku Petroll" Sh.p.k., Pejë - për impiantin për përpunim, thërrmim dhe seperimi i rërës dhe zhavorrit në Pejë, është konstatuar se mungon dokumentacioni në vijim:

- Pëlqimi mjedisor ekzistues pasi që behet fjale për zgjerim veprimtarisë.

Faqe 2 nga 4



- Në Njoftimin e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Pejës (Datë 28.03.2025), ceket se ngastra kadastrale nr. 05633-16 ZK Pejë është e përfshirë në Hartat Zonale 2023-2031 dhe është e destinuar "pjesërisht për afarizëm/Tregti dhe Banim Individual.
- Formulimi "pjesërisht" krijon paqartësi të mëdha ligjore dhe hapësinore.
- Raporti i VNM-së duhet të dëshmojë saktësisht nëse aktiviteti i përpunimit, thërmimit dhe separacionit të rërës bie brenda pjesës së destinuar për afarizëm, apo prek zonën e banimit individual. Për më tepër, ky dokument nuk te jep informacion për Lejimi i ushtrimit të veprimtarisë, çka nuk mjafton për të vërtetuar përputhshmërinë e plotë planifikuese për këtë lloj industrie.
- Dokumentet e sjellura duhet të jenë plotësisht të lexueshme, pasi dokumentacioni i ofruar paraprakisht ka qenë i paqartë dhe me kualitet teknik të papranueshëm për shqyrtim

Operatori duhet të sigurojë një konfirmim ose Pëlqim Urbanistik të qartë nga Komuna që specifikon se lokacioni i saktë i makinerive të separacionit nuk cenon zonën e banimit individual të cekur në njoftim (me koordinata).

- Raporti i VNM -së duhet të përmirësohet dhe duhet të behet korrigjimi i numërtimit të kapitujve, emërtimit të Ministrisë (MMPH) dhe eliminimit të fjalive të papërfunduara.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, paragrafi 2, 3 dhe 4, kompanisë "Qallaku Petroll" Sh.p.k., Pejë - për impiantin për përpunim, thërmim dhe seperimi i rërës dhe zhavorrit në Pejë, me datën 06.07.2026 i është dërguar njoftim për plotësim dokumentacioni.

Kompania nuk është përgjigje kërkesë për plotësim dokumentacionit (nuk ka sjell fare dokumentet shtese).

Prandaj, për tu shqyrtuar kërkesa e juaj, keni qenë të obliguar të sjellni dokumentacionin e lartcekur.

Bazuar në të lartcekurat, Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së merr vendim për **Përfundim të Procedurës Administrative**, për kërkesën për pajisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Qallaku Petroll" Sh.p.k., Pejë - për impiantin për përpunim, thërmim dhe seperimi i rërës dhe zhavorrit në ngastren kadastrale P-71611071-05633-16 në Z.K., Pejë.



Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Vërejtje: Vonesat në kthimin e përgjigjes janë shkaktuar për shkak të volumit të madh të kërkesave dhe ndërrimit të Komisionit për VNM.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/1872/- ZSP/ /26 datë: 28.08.2026

Prishtinë


Bajram Kafexholli
UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Pejës
7. Divizionit për komunikim me publikun
9. Arkivit të MMPH